



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR  
REKTORATI

Nr. 1574 Prot.

Gjirokastrë, më 18.10.2024

**Lënda: Hapet thirrja për pjesëmarrje në konferencën Week of Innovative Regions in Europe (WIRE)**

Konferenca **Week of Innovative Regions in Europe (WIRE)** do të zhvillohet në Budapest, Hungari në datat 13-14 nëntor 2024.

Konferenca organizohet nga Zyra Kombëtare e Kërkimit, Zhvillimit dhe Inovacionit (National Research, Development and Innovation Office) si partner zyrtar i Presidencës hungareze të Këshillit të Bashkimit European dhe shërben si forumi kryesor evropian për inovacionin dhe zhvillimin rajonal, duke bashkuar aktorët kyçë në fushat e inovacionit dhe arsimit për rritjen e konkurrueshmërisë të bazuar në shkencë.

Tema e këtij viti përputhet me prioritetet e presidencës hungareze dhe është jetike për konkurrencën e BE-së në të ardhmen. Eventi do të analizojë sfidat aktuale, do të ndajë praktikat më të mira dhe do të diskutojë iniciativat si koncepti i Smart Specialization, Instrumenti i Investimeve Ndërrajonale të Inovacionit (I3), Partneriteti për Inovacionin Rajonal. Folësit do të vlerësojnë efektivitetin e këtyre mjeteve dhe do të theksojnë sinergjitë ndërmjet skemave të financimit evropian dhe rajonal.

Për më shumë informacion dhe regjistrim në aktivitet klikoni [wire2024.nkfi.gov.hu](http://wire2024.nkfi.gov.hu). Regjistrimet për pjesëmarrje në aktivitet do të jenë të hapura deri në datë 8 nëntor 2024 (e premte), ora 12:00 CET.

Zv/Rektor  
Prof. asoc. Merita ISARAJ

*Merita Isaraj*

